



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA

K O D E K S

Për mirësjelljen e anëtarëve të FFK-së

Prishtinë, Shkurt 2010

Në bazë të nenit 33 p.3 a, të Statutit të FFK-së, Komiteti Ekzekutiv (KE) i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK-së), nxjerr këtë:

K O D E K S

Për mirësjelljen e anëtarëve të FFK-së

Neni 1

Kodeksi për mirësjelljen e anëtarëve të FFK-së (mëtej, Kodeksi) përcakton rregullat e sjelljes të anëtarëve të FFK-së, klubeve-udhëheqësive të tyre, trajnerëve, lojtarëve, gjyqtarëve të futbollit, vëzhguesve, kontrollorëve, anëtarëve të komisioneve dhe Shoqatave dhe të të gjithë anëtarëve të organeve dhe punëtorëve tjerë sportive, lidhur me aktivitetet e futbollit.

Qëllimi i Kodeksit është afirmimi i vlerave pozitive themelore në futboll dhe sidomos sjellja fer dhe korekte ndaj anëtarëve të klubeve si dhe organeve dhe zyrtarëve të futbollit.

Neni 2

Anëtarët e organizatave të futbollit punojnë në promovimin e futbollit me qëllim të rritjes së reputacionit në shoqëri. Çdo aktivitet i cili krijon përshtypje negative për futbollin do të konsiderohet sjellje e keqe.

Neni 3

Anëtarët e organizatave të futbollit obligohen që me kohë dhe përpikëri t'i zbatojnë rregullat e futbollit kundrejt të gjithë pjesëmarrësve të sportit të futbollit dhe obligohen të mbrojnë dhe ruajnë integritetin e institucioneve të futbollit, individëve si dhe të anëtarëve të organizatave të futbollit.

Neni 4

Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë të tentojnë, apo të ndikojnë në klube, gjyqtarë, vëzhgues, kontrollorë, trajnerë dhe lojtarë, që të veprojnë në kundërshtim me rregullat nga neni 3 i këtij Kodeksi.

Neni 5

Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë të tentojnë të ndikojnë në anëtarët e organeve të FFK-së të cilat sjellin vendime lidhur me garat ose vendime të tjera nga kompetenca e punës së këtyre organeve.

Neni 6

Anëtarët e organizatave të futbollit obligohen të kenë kujdes rreth autoritetit dhe sjelljes së tyre në jetën publike dhe private, dhe për autoritetin e organizatës së futbollit, anëtarë të së cilës janë si dhe për autoritetin e FFK-së.

Neni 7

Anëtarët e organizatave të futbollit gjatë kryerjes së funksioneve të tyre nuk guxojnë të pranojnë nga institucionet e futbollit apo individët , dhurata apo kompenzime tjera që janë kundër rregullave, përpos suvenireve ose simboleve sportive.

Neni 8

Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë gjatë deklaratave për media, të ofendojnë apo të përulin institucionet e organizatave të futbollit, të anëtarëve individual të tyre, nuk guxojnë të përhapin të pavërteta dhe të dhëna të rrejshme apo të gabuara lidhur me punën e institucioneve të futbollit dhe individëve, anëtarë të organizatave të futbollit.

Neni 9

Anëtarët e klubeve dhe punëtorët e tjerë të futbollit nuk guxojnë që për media, pas ndeshjeve, të japin deklarata fyese për gjyqtarë dhe gjykimin, si dhe për personat tjerë zyrtarë, të cilat do të dëmtonin autoritetin dhe integritetin e personave zyrtar.

Neni 10

Të gjitha vërejtjet ndaj personave zyrtarë të ndeshjeve dhe të organeve të punës, të cilët vendosin lidhur me garat dhe gjykimin, mund t'i drejtohen në formë të shkruar, udhëheqësisë së garave dhe organeve tjera kompetente, në bazë të akteve normative të FFK-së.

Neni 11

Trajnerët, lojtarët, anëtarët e udhëheqësive dhe punëtorët tjerë të futbollit mund të japin deklarata lidhur me ndeshjen, vetëm në bazë të këndvështrimit të funksionit të vetë (mënyra e lojës, organizimi i ndeshjes, sjellja e shikuesve etj).

Neni 12

Deklarata për media lidhur me punën e organizatave të sportit të futbollit (FFK, organet e saja, klubet dhe organet e tyre) mund të japin ekskluzivisht personat të cilët janë të autorizuar me akte për dhënjën e deklaratave në emër të organizatës së futbollit.

Neni 13

Punëtorët e punësuar në organet e FFK-së nuk mund të japin deklarata për media dhe t'i komentojnë vendimet e organeve pa pëlqimin e udhëheqësisë së FFK-së.

Neni 14

Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë që me veprimet e tyre të ftojnë ekipin e futbollit apo individin të lëshoj fushën e futbollit në asnjë rast.

Neni 15

Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë në asnjë mënyrë t'i shtyjnë lojtarët në mos përgjigje ndaj obligimeve të Përfaqësueses së Kosovës në futboll.

Neni 16

Çdo anëtar i organizatës së futbollit është i obliguar që të pengojë lojtarët e futbollit për përdorimin e mjeteve stimulative të palejuara (doping).

Neni 17

Shkelja e rregullave të këtij Kodeksi paraqesin kundërvajtje disiplinore, e cila, në bazë të fletë paraqitjës së deponuar të cilën mund ta bëjnë të gjithë anëtarët e organizatave të futbollit, sanksionohen në bazë të Rregullorës disiplinore të FFK-së.

Neni 18

Ky Kodeks hyn në fuqi ditën e parë të punës pas aprovimit të saj nga ana e KE-së të FFK-së.

Prishtinë, 23 Shkurt 2010

Kryetari i FFK-së

Fadil Vokrri